UNIVERSITETI I MITROVICËS
'ISA BOLETINI'

Programi mësimor i lëndës (Syllabusi)		
Fakulteti:	Fakulteti Ekonomik	
Programi/Departamenti:	Biznes dhe Menaxhment/Specializimi: Menaxhment dhe Ndërmarrësi	
Niveli:	Bachelor	
Kodi i lëndës:		
Lënda:	Menaxhimi i NVM-ve	
Statusi i lëndës:		Obligative
Semestri:		Dimëror
Fondi i orëve:	2+1	Sipas programit të aprovuar
ECTS:	7	Sipas programit të aprovuar
Orari/Salla		
Viti akademik:	Viti i II, Semestri i III	
Mësimdhënës/e:	Prof. Ass. Dr. Filloreta Kunoviku Demiri	
Asistent/e:	Arif Krasniqi, PhDc	
Kontaktet:	Mësimdhënës/e	Asistent/e
E-mail:	filloreta.demiri@umib.net	arif.krasniqi@umib.net
Telefon:	+ 383 (0) 45 701 789	+383 (0) 49 494 031

PERMBAJTJE	Rëndësia e NVM-ve për zhvillimin ekonomik është e pakthyeshme, përderisa ato konsiderohen si shtylla kurrizore e ekonomisë së një vendi. Ato përbëjnë shumicën e bizneseve në tregjet globale, kontribuojnë në rritjen dhe prosperitetin ekonomik në nivel kombëtar dhe janë shtytësit kryesorë të punësimit dhe inovacionit. Ky kurs do të marrë në konsideratë menaxhimin e këtyre kontribuesve thelbësorë në ekonomitë globale dhe kombëtare.
QËLLIMI	Objektivi parësor i kësaj lënde është të informojë studentët për natyrën dhe rëndësinë e biznesit të vogël dhe të mesëm në shoqërinë tonë. Për më tepër, të përfshijë fakte për NVM-të, aftësitë thelbësore të menaxhimit, mënyrën e përgatitjes së një plani biznesi, nevojat financiare, strategjitë e marketingut, format e pronësisë, planifikimin, organizimin dhe menaxhimin, analizën e fizibilitetit, financimin, ekskluzivitetin, fillimin ose blerjen e një biznesi të vogël dhe fusha të tjera përkatëse që lidhen me këtë fushë.

<table>
<tr><td>ARRITSHMËRIA</td><td colspan="2">❑ Me kompletimin e lëndës, studentët do të jetë në gjendje të:

1. <u>Përshkruajnë</u> rëndësinë e biznesit të vogël dhe të mesëm,
2. <u>Analizojnë</u> në mënyrë kritike karakteristikat, sjelljen dhe motivimet e NVM-ve në pronësi të familjes dhe arrijnë në përfundime të informuara në lidhje me të ardhmen e NVM-ve,
3. <u>Vlerësojnë</u> natyrën e mjedisit të biznesit pasi ndikon në biznesin e vogël në pronësi të familjes dhe vlerësoni mundësitë dhe kërcënimet e biznesit,
4. <u>Zbatojnë</u> praktikat për menaxhimin e përditshëm të NVM-ve dhe të kuptojnë siç duhet menaxhimin e NVM-ve
5. <u>Argumentojnë</u> rëndësinë e kreativitetit dhe inovacionit për NVM-të në pronësi të familjes dhe për zhvillimin e mundësive të biznesit, dhe
6. <u>Hartojnë</u> planin e biznesit për NVM-të, duke inkorporuar rëndësinë e planifikimit financiar, dhe kontributin e suksesit të marketingut.</td></tr>
<tr><td rowspan="16">PROGRAMI</td><td>Javët</td><td>Tema</td></tr>
<tr><td>Java - I</td><td>Përmbajtja dhe njohja me lëndën (Syllabusi) si dhe Hyrje në Menaxhimin e NVM-ve</td></tr>
<tr><td>Java - II</td><td>Definimi i NVM-ve</td></tr>
<tr><td>Java - III</td><td>Ndërmarrësia dhe Ndërmarrësi si Krijues i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme</td></tr>
<tr><td>Java - IV</td><td>Idetë, Motivet dhe Llojet e Ndërmarrësisë</td></tr>
<tr><td>Java - V</td><td>Gjenerimi i Ideve dhe Teknikave Ndërmarrëse</td></tr>
<tr><td>Java - VI</td><td>Krijimi dhe Organizimi i NVM-ve</td></tr>
<tr><td>Java - VII</td><td>Kollokviumi i Parë</td></tr>
<tr><td>Java - VIII</td><td>Planifikimi i Biznesit</td></tr>
<tr><td>Java - IX</td><td>Plani i Biznesit, Struktura e tij dhe Metodologjia e Dizajnimit</td></tr>
<tr><td>Java - X</td><td>Analizat SWOT dhe Mjedisi i Biznesit</td></tr>
<tr><td>Java - XI</td><td>Plani i Marketingut, Analiza e Tregut dhe Analiza Financiare</td></tr>
<tr><td>Java - XII</td><td>Barrierat e Menaxhimit dhe Rritjes së NVM-ve</td></tr>
<tr><td>Java - XIII</td><td>Mjedisi i biznesit dhe roli i institucioneve qeveritare dhe joqeveritare</td></tr>
<tr><td>Java - XIV</td><td>Ligjëratë përmbledhëse dhe Prezentimi i punimeve seminarike, eseve, punës në teren, punës në grupe, etj.</td></tr>
<tr><td><u>Java - XV</u></td><td>Kollokviumi i Dytë</td></tr>
</table>

LITERATURA

Literatura themelore:

1. Besnik Krasniqi (2012): Entrepreneurship and Small Business in Kosovo, Nova Science Publisher, New York, USA.

Literatura shtesë:

1. David Stokes and Nick Wilson: Small Business Management and Entrepreneurship, 6th edition, 2010
2. Mathias Fink and Sascha Kraus: The management of Small and Medium Enterprises, Routledge Studies in Small Business, 2009
3. Alkis Thrasou, Demtris Vrontis, Yaakov Weber, S.M. Riad Shams and Evangelos Tsoukatos: The Changing Role of SMEs in Global Business, Palgrave Macmillan, 2020

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNJËS

Në kuadër të këtij semestri janë të paraparë 15 Javë me nga 2 orë ligjërata dhe 1 ushtrime (seminare dhe diskutime), si dhe dy kollokfiume të cilat mbahen brenda 15 ligjëratave të planifikuara (javën e 7 dhe 15). Studimet e rastit dhe detyrat e shtëpisë jipen pas çdo ligjerate për studentët me qëllim që studentët të studiojnë dhe hulumtojnë në kohën e studimeve vetanake.

Rezultatet nga aktivitetet e tilla paraqiten dhe diskutohen në javën vijuese. Studentët inkurajohen për të ndjekur zhvillimet aktuale ekonomike duke lexuar artikuj, gazeta ekonomike si dhe materiale të tjera relevante. Ata mund të identifikojnë çështjet/temat e radhës për diskutim nga lexime të tilla. Esetë e përgatitura nga studentët gjithashtu do të diskutohen si dhe inkurajohen prezantimet individuale dhe grupore.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit – 1 ECTS kredi = 25 orë)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15 javë	30
Ushtrime	1	15 javë	15
Konsultime me mësimdhënësin/asistenten	1	1 javë	15
Kolokiume /seminare	2	2 javë	4
Detyra të pavarura			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	5	15 javë	75
Përgatitja përfundimtare për provim	5	6 javë	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final	/	/	/
Projektet, prezantimet, etj	2	5 javë	10
Totali			**179 orë**

VLERËSIMI	**Metodat e vlerësimit** Vlerësimi në % Testi i –I-rë, me shkrim .....25% Testi i – II-të, me shkrim .....25% Aktiviteti në klasë .....10% Punime seminarike.....10% Povimi final .....30% **Shkallët e notave** : 50-me pak – nota 5 (pesë) 51-60 % - nota 6 (gjashtë) 61-70 % - nota 7 (shtatë) 71-80 % - nota 8 (tetë) 81-90 % - nota (nëntë) 91-100 % - nota (dhjetë)
POLITIKAT AKADEMIKE	Studentët pritet të marrin pjesë rregullisht në ligjërata. Ata pritet gjithashtu të jenë aktiv në ligjërata, seminare dhe diskutimeve individuale dhe grupore. Profesori është në dispozicion për konsultime individuale. Studentët janë të detyruar për të lexuar literaturë para çdo ligjërate. Studenti është i obliguar të vijojë ligjërata dhe ushtrime. Plagjiatura dhe kopjimi në provime janë të dënueshme sipas statutit dhe rregulloreve të tjera te universitetit. Kodi e mirësjelljes vlen si për studentët ashtu edhe për mësimdhënësit.

Mitrovicë

19/12/2021

Bartës/e i/e lëndës:

Prof. Ass. Dr. Filloreta KUNOVIKU DEMIRI

_____

(Emër Mbiemër)

_____

(Nënshkrimi)